

L I G J
Nr.7842, datë 7.7.1994

**PËR FALJEN E DETYRIMEVE TË VITIT 1992 DHE 1993 TË BASHKËSIVE EKONOMIKE
NDAJ BUXHETIT TË SHTETIT**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Të falen detyrimet që kanë bashkësitë ekonomike të Albpetrolit, KESH-it, Albkromit dhe Albbakrit ndaj buxhetit të shtetit për akcizën dhe tatimin mbi qarkullimin, të pashlyera deri më datën 31.3.1994 dhe që i përkasin viteve 1992-1993.

Neni 2

Për detyrimet e falura bashkësitë ekonomike të bëjnë rregullimet në kontabilitet, duke i sistemuar ato me kapitalin themelor.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.890, datë 14.7.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.